



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 7/2 prot.,

Datë 04.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19-12-2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK me Nipt J62426002Q. Adresa: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fushë-Arrëz
Adresa: Qendër Fushë-Arrëz.

Në datën 03.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 07 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-82208-10-04-2023, me objekt “Blerje materiale kancelarie për Bashkinë Fushë-Arrëz”, me fond limit 1,384,166 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19-12-2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”.

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK, kundërshton në ankesën e ardhur më datën 03.01.2024 me Nr. 07 Prot., pranë Komisionit të Prokurimit Publik,

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

O.E "InfoSoft Office" nuk ploteson kriteret sipas DST-se, si mëposhte:

Vertetimi i tatimeve, rezulton se ka detyrime (gjoba) në Tatimin në Burim në shumën 812,500 lekë për të cilën ndodhet në proces ankimi, të kërkuar në DST sipas shtojcës 7, pika 1, “Kriterët e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma (dh).

Vertetimi i OSHE, nuk përfshihet fatura kohërente e muajit Nëntor, të kërkuar në DST sipas shtojcës 7, pika 1, “Kriterët e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma (e).

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.01.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri